

# RISEMANTIZIMI I SIMBOLEVE MITIKE NË POEZINË E ALI PODRIMJES

**Jolanda LILA**

Kolegji Universitar, „Hëna e Plotë - Beder“, Tiranë

**UDC 821.18-1.09**

*Conference paper*

## **Abstract**

The poetry of Ali Podrimja marks that form of writing where modern features are entirely prevalent. In this paper, we will study symbolical language as the representative features of his poetics. Given that symbols are diverse, it was seen as necessary to analyse a certain typology, which is why we focused on the mythological symbols. There is also another reason for this and that is because this return to myth is one of the most typical features of modern day poetry and it has been used as a way to build the apocalyptic vision of the world and to convey the universal spirit.

In this paper we attempt to find the reason behind Podrimja's return to the mythological subject, the new meaning these symbols are associated with and the figures of speech generated by this field in poetry. A special entry has been dedicated to the classification of symbols based on their frequency of use and to the explanation of results referring to the poetical context where each use has appeared. The order in which symbols appeared was never random, but always denoted a certain meaning, which oftentimes reflected images from the historical reality.

**Key words:** *Poetry, myth, new meaning, context.*

## **Përmbledhje**

Poezia e Ali Podrimjes shenjon trajtën e shprehjes poetike moderne. Simboli është një nga figurat dominuese të poezisë së tij, veçanërisht simboli mitik. Rikthimi në mit lidhet me trajtën tipike të poezisë e letërsisë moderne, si një mënyrë për të ndërtuar vizionin apokaliptik për botën dhe për përcjelljen e frymës universale. Vërehet se shtrirja e simboleve mitike në poezinë e Podrimjes është mjaft e gjerë dhe burimet e prejardhjes së tyre janë të shumta. Kjo kumtesë rreket të tregojë arsyen se pse Ali Podrimja i rikthehet lëndës mitologjike, cili është kuptimi i ri, që aktualizohen këto simbole dhe cilat janë përftesat e këtij lëmi në poezi.

Për të nxjerrë në pah këto tipare, simboli mitologjik nuk është studiuar më vete, por është parë në kompleksitet dhe është ballafaquar gjithnjë me dysinë kontekstuale: poetike dhe historike.

**Fjalët kyçe:** *Poezi, mit, rikuptimësim, konteksti.*

Simbolet mitike në poezinë e Ali Podrimjes janë të shumtë dhe të llojeve të ndryshme. Të ndryshëm janë ata edhe sipas kohës së krijimit të tyre. Bazuar në tipologjinë që i bëhet mitologjisë sipas rendit kronologjik dhe botëkuptimit përkatës, nga studiuesi Alfred Uçi, do të mund të thuhej se në këtë poezi gjenden elemente të secilit klasifikim. Në të ka simbole mitologjike të të gjitha kohëve, pra, prej të gjitha shtresimeve:<sup>1</sup>

1- *Ulkonja, korbat, sorrat, ujku, dhelpra, merimanga, minjtë, qentë, plepi* etj. Këto janë simbole të mitologjisë arkaike primitive, që kanë lindur në komunitetin primitiv dhe kanë si figura mbizotëruese kafshët, e më pak figurat e bimët. Në këtë tip mitologjie përfshihet pjesa e krijimeve folklorike.

2- *Prometeu, Sizifi, Dodona, Anteu, Hadi, Persefoni, Kentauri, Minotauri* etj. Këto janë simbole të mitologjisë klasike që kanë qarkulluar në artin dhe në letërsinë e shoqërisë antike. Ato mbartin mbeturina të miteve arkaike, por kanë edhe elemente të reja të formuara nën ndikimin e fesë, artit, filozofisë dhe faktorëve të tjerë. Kjo mitologji fitoi karakter antropomorfik, pra perënditë u veshën me cilësitë dhe pasionet njerëzore.

3- *Zoti, bibla, djalli, ferri, varka e Noes, satanai, Nazareti, Krishti* etj. Këto janë simbole të mitologjisë fetare që zëvendësuan mitologjinë klasike të besimit politeist me besimin monoteist.

Përbërësit mitologjikë, pavarësisht kohës apo shtrirjes gjeografike, në poezinë e Ali Podrimjes paraqiten të resemantizuara dhe janë simbole që shëmbëllojnë një varg konceptesh e idesh për dukuritë bashkëkohore. Meqenëse qasja përqendrohet tek funksionalizimi i elementeve të mitologjisë klasike (mitet e periudhës politeiste), atëherë këto lloje simbolesh janë pika kryesore e referencave ilustruese. Tipari kryesor i simboleve mitologjike është kolektiviteti dhe pikërisht këtë element, Podrimja e shfrytëzon në funksion të përmbajtjes poetike të krijimtarisë së tij, e cila ka në thelb fatin kolektiv, me aspekte të ndryshme të tij në kontekstin shqiptar.

---

<sup>1</sup> Uçi, Alfred. *Mitologjia, folklori, letërsia*, Sh.B. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982, fq. 13.

Ristrukturimi, përpunimi i imazhit arketipor, bëhet në funksion të përkthimit të këtij imazhi në gjuhën e së tashmes, në funksion të aktualizimit të tij. Kështu, simboli mitologjik Troja nuk sjell shëmbëlltyrën e vendbanimit historik me vlera arkeologjike, por shëmbëlltyrën e vendbanimit të mitologjizuar dhe me vlerë arketipore. Kjo kuptohet qartësisht në lidhjen e këtij simboli me Kalin e Trojës dhe me vargun e Homerit:

*Kthehu në vargun e Homerit*

*kthehu atje prej nga erdhe*

*koha jote s'është kjo*<sup>2</sup>

*(“Nga Kali i Trojës”, f. 339)*

Kërkesa për rikthimin në origjinë merr shkas nga Kali i Trojës dhe shkatërrimi apokaliptik që shkaktoi. Kali i Trojës kthehet në njësi arketipore që shfaqet edhe në kohën moderne, prandaj subjekti lirik kërkon që ai të shkojë në lashtësi dhe të mos veprojë në bashkëkohësi: kthehu atje prej nga erdhe/koha jote s'është kjo. Kali i Drunjtë është simbol i dinakërisë e tradhtisë, është mjeti dhe mënyra e shkatërrimit të Trojës. E për këtë arsye, subjekti lirik kërkon kthimin e tij në origjinë, sepse koha e tij ka perënduar.

Kërkesa e vazhdueshme për rikthim nuk vjen vetëm nga fakti se kalit të drunjtë i ka kaluar koha fizike (ku kanë kaluar disa mijëvjeçarë dhe ai duhet të ishte shuar që në antikitet), por atij i ka kaluar edhe koha psikologjike, sepse dinakëria, tradhtia dhe shkatërrimi janë mjete që iu ka mbaruar koha e ekzistencës dhe nuk mund të gjejnë hapësirë edhe në botëkuptimin e bashkëkohësisë. Ato kontrastojnë me logjikën e zhvillimit të botës moderne dhe janë mekanizma tepër të egra dhe çnjerëzore, prandaj kërkohet kthimi në vargun e Homerit. Këtë simbol mitologjik, Podrimja e rifunksionalizon në kontekstin politik e shoqëror të Kosovës e më gjerë.

Arketipi i Trojës aktualizohet me Kosovën. Për të shkatërruar Trojën, bashkohen kundër saj shtetet e Greqisë dhe në analogji me këtë përlëshje barbare të antikitetit, shfaqet aktualiteti, ku shtetet e Jugosllavisë bashkohen për të shkatërruar Kosovën. Me gjithë qëndresën dhe mbrojtjen, si pasojë e tradhtisë, qyteti bie. Rënia sjell humbjen e lirisë, shkakton ankth, pagjumësi, përndjekje, por edhe përsëritje të sulmeve. Kërkesa për t'u çliruar shtrohet në formë domosdoshmërie, meqenëse lufta i përket një kohe tjetër të shkuar.

---

<sup>2</sup> Podrimja, Ali. *Litari i ankthit*, poezi të përzgjedhura, botimet TOENA, Tiranë, 2002, fq. 339.

*liroji njerëzit prej vetvetes  
e hijeve liroji prej maskave  
e ikjeve liroji prej pagjumësisë  
e heshtjeve liroji prej etheve  
e shirave koha jote s'është kjo  
kthehu në vargun e Homerit  
Troja ra e marsejezën  
kahmot se këndojnë njerëzit*

*(“Nga Kali i Trojës”, f. 339)*

Ashtu siç mund të lexohet simboli mitologjik i rifunksionalizuar në dy boshte: horizontalisht dhe vertikalisht (pra, evolucioni prej mitit origjinor në atë letrar), ashtu mund të lexohen edhe këto vargje nga pikëpamja strukturore. Përveç leximit të zakonshëm horizontal, kjo poezi lexohet edhe vertikalisht, nëpërmjet mundësisë që krijohet nga pranëvënia e qëllimshme “josintaksore” e nënshtresave kuptimore. Të bën përshtypje çoroditja e trajtave rasore të fjalëve, të cilat paçka se nuk kanë harmoni sintaksore, kanë një koherencë perfekte semantike.

Kështu, në vend që të përdoret fjalia vargore “hijet liroji prej maskave”, autori bën kombinimin e sememave, duke përfutur vargun “e hijeve liroji prej maskave” dhe kjo logjikë strukturimi vazhdon deri në vargun e parafundit “kthehu në vargun e Homerit”. Kjo parregullsi gramatikore e përdorimit të trajtave rasore apo lakueshmërisë së emrit nuk e pengon përcjelljen e mesazhit, por përkundrazi e bën më të fuqishëm atë, sepse elementet që pranëvihen i përkasin të njëjtës fushë leksikore: hije-maskë; ikje-pagjumësi; heshtje-ethe etj.

Njëkohësisht, kjo lloj përfutese krijuese është treguese e gjendjes së amullisë që e karakterizon realitetin, në të cilin qëmtimi dhe lakueshmëria e saktë mbetet utopi. Sipas boshtit vertikal ose paradigmatic, leximi i kësaj poezie realizohet i udhëhequr nga pjesa kryesore “liroji njerëzit prej...” dhe derivatet e kësaj pjese janë të larmishme, sepse kemi disa kombinime.

liroji njerëzit prej:  
vetvetes  
hijeve  
ikjeve  
heshtjeve  
shirave<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Podrimja, Ali. *Litari i ankthit*, poezi të përzgjedhura, botimet TOENA, Tiranë, 2002, fq. 339.

Leximi sipas të dyja boshteve, qoftë boshtit sintagmatik, qoftë atij paradigmatic, të çon në të njëjtën rrugë dhe përvijon tiparet e simbolit mitologjik të Kalit të Trojës. Lirimi prej *vetvetes* shenjon largimin prej strategjemës dhe shpikjes së mbrapshtë të bërë nga vetë njerëzit; *hija* nënkupton largimin prej ushtarëve të fshehur brenda Kalit të Trojës; *ikja* është tregues i tmerrit të përjetuar prej pabesisë; *heshtja*, është pajtimi me situatën pa rrugëdalje; *shirat*, janë shenjues të përleshjeve dhe sulmeve.

Këto domethënie të simbolit mitologjik, risemantizohen dhe universalizohen nga Podrimja, duke përcjellë elementet thelbësore të çdo lufte, pavarësisht kohës dhe vendit ku zhvillohet. Cënimi i vazhdueshëm i identitetit vetjak e kombëtar, përndjekjet, dëbimet, ecejaket në kërkim të hapësirave më të sigurta, pasiguria, pagjumësia, rrebeshi i dhunës dhe i terrorit, përdhunimi e eliminimi fizik janë përbërësit kryesor të luftës, që dekodifikohen nga vargjet e Podrimjes.

Në vargun e fundit të poezisë “Kthehu në vargun e Homerit” përmendet marsejeza, himni kombëtar i Francës. Himni është mjet identifikues i një populli dhe këndohet për të forcuar atdhetarizmin. Ai rresht së kënduari atëherë kur kombi humbet lirinë. Marsejeza është himni i fitores, por pas disfatës dhe rënies nuk këndohet më. Kur Marsejeza ishte kthyer në himnin nacional francez, pothuaj një shekull më pas, rilindasi shqiptar Thimi Mitko, i mërguar në Egjipt, shkroi dhe shpërndau ndër shqiptarët këngën e tij të titulluar “Marsejeza”.

Një poezi që qarkulloi si fletë-volante më 1880, për të ngritur peshë zemrat e djalërisë shqiptare në luftë për mbrojtjen e fateve kombëtare dhe shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Otomane. Pra, bëhet fjalë për një adaptim në shqip të "Marsejezes" franceze të vitit 1792, edhe pse me strofa të shtuara nga Mitko, që pasqyrojnë gjendjen politike të Shqipërisë në atë kohë.<sup>4</sup> Një tjetër variant i “Marsejezës shqiptare” vjen edhe në poezinë e Ali Podrimjes, misioni krijues i të cilit përngjason me idetë e Rilindjes kombëtare shqiptare.

Në opusin poetik të rilindësve qëndronte shëmbëlltyra ideale e atdheut, në një kohë kur po formohej kombi shqiptar, ndërsa në botëkuptimin e Podrimjes zë vend rikrijimi i shëmbëlltyrës së etnisë shqiptare, në një kohë kur hapësira e kombit shqiptar ishte tkurrur dhe identiteti i tij vazhdon të çenohet. Autori merr elemente të kulturave të ndryshme dhe të kohëve të ndryshme, prej antikitetit grek vjen në Francën e shek.18, për të përcjellë idenë se dukuria e sulmeve, dinakërisë dhe tradhtisë është e pranishme kudo dhe kurdo. Prandaj subjekti lirik kërkon që dukuri të tilla të mos përsëriten, por të mbeten në suazat e kohës që i prodhoi. Si përfundim, themi që simboli i Trojës dhe i Kalit të Drunjtë vishen me një kuptim

---

<sup>4</sup> Rama, Luan. “Regnum Albanie”, gazeta “Korrieri”, Tiranë, 18 mars, 2005, fq. 11.

të ri, risemantizohen, duke u përshtatur jo vetëm me mjedisin shqiptar, por dhe me bashkëkohësinë.

Karakteristikë e poezisë së Podrimjes është se i njëjti simbol mitik haset disa herë brenda së njëjtës poezi, ose paraqitet në poezi të ndryshme. Në përdorimet letrare kodifikohen kuptime e mesazhe të larmishme, varësisht nga sfondi kontekstual. Në poezinë “Pres me ditë tres përditë” simboli mitologjik i Sizifit paraqitet në dy kontekste paradoksale me njëri-tjetrin:

*Hedh gurin në hapësirë*

*Sizifi plak me mund*

...

*kohëra e kohëra përgjak*

*dhe mund Sizifin plak.*<sup>5</sup>

(“Pres me ditë tres përditë”, fq. 61)

Arkitekti e paraqet Sizifin duke u ngjitur në një rrëpirë me një gur të stërmadh në shpinë, i cili pasi arrinte në majë, rrokullisej sërish poshtë. Thënia “mundimi i Sifizit” është bërë proverbiale për të treguar një përpjekje sa të madhe, aq edhe të kotë.<sup>6</sup> Tiparet identifikuese të variantit origjinar të simbolit mitologjik të Sizifit do të ruhen edhe në transtekstualitetin podrimjan. Dy elementet më intriguese të mitit: Sizifi dhe guri do të vazhdojnë të jenë në qendër, por raporti midis tyre është i ndryshëm tashmë, madje është një marrëdhënie e përmbysur.

Varianti poetik ka përfutur një Sizif të shpërfytyruar, sepse në bashkëkohësi ka ndërruar forma e ndëshkimit ndaj tij. Në vend që ta ngjisë gurin, ai duhet ta zbresë atë, duke e hedhur në hapësirë: Hedh gurin në hapësirë/Sizifi plak me mund. Kjo është një hedhje e mundimshme, mbi të gjitha se heroi mitologjik shfaqet i plakur dhe energjitë e tij janë të sforcuara. Hedhja e gurit në hapësirë është metonimi e kufijve të Shqipërisë, sepse nënkupton hedhjen e themeleve, apo përcaktimin e kufijve.

Si shenja dalluese për ndarjen e kufijve mes shteteve kanë shërbyer gjithnjë gurët dhe kjo shenjë konvencionale e natyrës ka një rol të fuqishëm në jetën e çdo vendi. Sifizi është ngritur në sistem simbolik, duke u identifikuar me pushtuesin e etnisë shqiptare, që gjithnjë i ka zhvendosur gurët e kufijve të saj, duke e tretur përditë. Sizifi i plakur shenjon pushtuesit

---

<sup>5</sup> Podrimja, Ali. *Litari i ankthit*, poezi të përzgjedhura, botimet TOENA, Tiranë, 2002, fq. 61.

<sup>6</sup> New Larousse Encyclopedia of Mythology, Crescent Books, New York, 1987, fq. 515.

shumëshekullorë të shqiptarëve, të cilët pavarësisht gjakderdhjes e uzurpimit të hapësirave, nuk kanë arritur që të shpërbëjnë identitetin e hapësirës shqiptare: pres me ditë tres përditë/hapësirë e hapësirë kërkon.

Kërkesa e përhershme për hapësirë nuk mbetet thjesht në nivelin e një kërkesë, por kthehet në një element shpotitës e zhuritës nga veprimi konkret, që paraqitet përmes vargut “hapësirë çpon e çpon”. Në rimarrjen e dytë të këtij simboli mitologjik përcillet dukuria triumfuese e etnisë, pavarësisht përgjakjes nëpër kohëra. Risemantizimet e ndryshme të të njëjtin simbol në këtë poezi realizohen përmes kombinimit të sememave të njëjta. Në versionin e parë, Sizifi plak e hedh gurin me mund dhe është në pozitat e sulmuesit, ku metonimikisht pushtuesit i duhen shumë mundime për të përvetësuar e copëtuar etninë shqiptare.

Ndërsa në variantin e dytë, Sizifi shfaqet brenda logjikës së tij proverbiale, që pavarësisht tentativave e mundimeve, ai sërish do të kthehet në pikën fillestare, sepse veprimtaria e tij nuk ka rezultat: kohëra e kohëra përgjak/dhe mund Sizifin plak. Pra, në rimarrjen e dytë, ai del i mundur dhe hedhja e gurëve apo sulmet e tij i dhurojnë atij dështimin, i cili është edhe fati i vet i pashmangshëm. Faza moshore e Sizifit plak përngjason me moshën e etnisë, madje ata janë bashkëmohatarë, sepse rrënjët e etnisë shqiptare janë aq të lashta, sa dhe koha në të cilën janë prodhuar rrëfimet mitologjike.

Gjithashtu, edhe pushtimet ndaj etnisë janë mijëravjeçare, të herëpashershme, nga pushtues të ndryshëm, por me qëllim të njëjtë, pikërisht përvetësimi i hapësirës dhe i identitetit të saj. Rimarrjet e të njëjtit simbol mitologjik në poezi të ndryshme janë të shtresëzuara kuptimisht dhe i përngjajnë një palimpsesti. “Prania e këtyre simboleve të kujton negativët e një filmi tek njëri-tjetri dhe gjuhën e palimpsestit ku gjuha mbetet një, por e zbehtë në forma të zbrazura dhe e shfuqizuar nga kuptimi i saj fillestar, ajo është tjetërsuar dhe është bërë e huaj, por jo për subjektin lirik”.<sup>7</sup>Kuptimi nuk shteret me një përputhje referenciale të shfaqjes së simbolit, por mbart mundësinë e prodhimit të pafund të konotacioneve, nga ato të afërta e deri te ato më të largëtat që vështirë të identifikohen me pika referencash që ne njohim.

“Mitologjia është qendër e përvojës imagjinare, ndërsa simboli është një përfytyrim me domethënie të shumëfishtë dhe këto dy tipare shpjegojnë ndërtimin e simbolit letrar mitologjik.”<sup>8</sup> Podrimja e bën pjesë organike të poezisë së tij këtë lloj simboli, duke e veshur

---

<sup>7</sup> Lumi, E. “Metamorfozat“, Tiranë, 2006, fq. 182.

<sup>8</sup> Frye, Northrop. “Anatomy of criticism”, New Jersey Princeton University Press, Princeton, 1990, fq. 126.

me rrobën e aktualitetit, duke përcjellë botën shqiptare me tipare universale. Me anë të mbështetjes të tradita, miti dhe simbolet, autori luan një rol të rëndësishëm për originalitetin dhe fytyrën e poezisë shqipe bashkëkohore.

Simbolet mitologjike përsëriten në kohë të ndryshme dhe zbulojnë domethënie të reja. Në përhershmerinë ripërtëritëse të këtyre simboleve ndikon struktura poetike, që konceptohet si pjesë e simbolit të jashtëm, centrifugal, e cila mundëson daljen jashtë leximit, nga fjalët e veçanta në gjërat që nënkuptojnë ato ose, praktikisht në kujtesën e asosacioneve konvencionale ndërmjet tyre.<sup>9</sup>Pavarësisht mënyrës së përdorimit, simbolet mitologjike të ripërtëritura nga Ali Podrimja kanë një emërues të përbashkët funksional: rrezikun e zhbërjes së esencave kulturore, politike e kombëtare shqiptare nga trysnia e vazhdueshme e politikës agresive dhe shoviniste, nga njëra anë, si dhe shpalosjen të një varg dobësish tona të brendshme, në rrafsh politik dhe kulturor.

### **Bibliografia**

Frye, Northrop. "Anatomy of criticism", New Jersey Princeton University Press, Princeton, 1990.

Lumi, E. "Metamorfozat", Tiranë, 2006.

New Larousse Encyclopedia of Mythology, Crescent Books, New York, 1987.

Podrimja, Ali. *Litari i ankthit*, poezi të përzgjedhura, botimet TOENA, Tiranë, 2002.

Rama, Luan. "Regnum Albanie", gazeta "Korrieri", Tiranë, 18 mars, 2005.

Uçi, Alfred. *Mitologjia, folklori, letërsia*, Sh.B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1982.

---

<sup>9</sup> Po aty, fq. 104.